

Nr. 3242 Prot
02.07.08.2026

Për dje: Rruga B. Rrogozhinë
Për zbatim: Dr. Uibane
- Dr. Radasi
- Mj. Adm. Ickaj
- Mj. Adm. Gose
ALBANIAN RAILWAYS

Nr. 465 Prot

Durrës, më 27.8.2026

Lënda: Kërkesë për riorganizimin e takimeve të konsultimit publik në Bashkinë Rrogozhinë dhe Bashkinë Kavajë për Projektin "Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës – Rrogozhinë"

Drejtuar: Z. Fisnik QOSJA
Kryetar i Bashkisë
Adresa: Bashkia Kavajë,
Shëtitorja "Josif Bundo"

Kavajë

Z. Andi PROCKA
Kryetar i Bashkisë Rrogozhinë
Adresa: Lagjja nr. 1, Rruga e "Kavajës",
Blloku "12 Shtatori"

Rrogozhinë

Për dje: AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
Adresa: Rruga "Sami Frashëri", Tiranë
E-mail: info@akm.gov.al

Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë
Adresa: Rruga Halit Bega 86, Tiranë
E-mail: arntirane@akm.gov.al

Tiranë

Të nderuar,

Së pari, dëshirojmë t'ju falënderojmë sinqerisht për bashkëpunimin, mbështetjen dhe koordinimin tuaj të vazhdueshëm gjatë procesit të organizimit dhe zhvillimit të konsultimeve publike në kuadër të projektit.

Pas realizimit me sukses të takimit të konsultimit publik në Bashkinë Durrës, si dhe takimit me publikun dhe palët e interesuara në nivel qendror pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ju bëjmë me dije se procesi i njoftimit dhe publikimit të konsultimeve publike është zhvilluar në përputhje të plotë me kërkesat e legjislacionit në fuqi, përfshirë VKM nr. 247, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore", si dhe aktet e tjera përkatëse.

Megjithatë, pavarësisht përmbushjes së të gjitha procedurave ligjore të njoftimit, pjesëmarrja e publikut në konsultimet e zhvilluara në Bashkinë Kavajë dhe Bashkinë Rrogozhinë rezultoi e pamjaftueshme. Për këtë arsye, dhe me qëllim garantimin e një procesi sa më gjithëpërfshirës dhe efektiv të konsultimit publik, vlerësojmë të nevojshme riorganizimin e këtyre dy takimeve.

Sa më lart, propozojmë që konsultimet publike të riplanifikohen në datën **11 gusht 2026**, sipas këtij programi:

- Bashkia Rrogozhine: Vendi: Stacioni i Trenit Rrogozhinë, Ora 10:00;
- Bashkia Kavaje: Vendi: Salla e Kinemasë Kavajë (Përballë Bashkisë), Ora 12:00;

Vlerësohet me shumë interes informimi, njoftimi dhe pjesëmarrja në këtë takim të institucioneve lokale, komuniteti, bizneset dhe më gjerë.

Për rrjedhojë, Hekurudha Shqiptare fton për pjesëmarrje në takim palët si më poshtë:

- Punonjës të Bashkisë Kavajë që mbulojnë aspektet mjedisore, sociale, zhvillim e territorit, ujësjelles kanalizimet, mirëmbajtjen e rrjetit të ujitjes dhe kullimit, etj;
- Kryetarët dhe punonjësit e njësive administrative të Bashkisë Kavajë dhe që preken nga gjurma e hekurudhës;
- Kryeqleqte e fshatrave, banorët dhe bizneset e vendbanimeve/fshatrave në afërsi të linjës hekurudhore;
- Përfaqësues të institucioneve arsimore dhe shëndetësore në afërsi të linjës hekurudhore;
- Përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që punojnë dhe/ose zbatojnë projekte në vendbanimet në afërsi të zonës së projektit, nëse ka të tilla, etj.

Nga ana e HSH, pika e kontaktit për këtë proces konsultimi do të jetë:

Adresa postare: *Pranë Hekurudha Shqiptare, Lagjia nr. 3, Rruga Egnatia, Durrës ose adresa elektronike: eriton.hasaj@hekurudha.al, numrin e telefonit: +355 67 222 1452.*

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mbështetjen tuaj gjatë gjithë fazave të zhvillimit të këtij projekti të rëndësishëm jo vetëm për Hekurudhen Shqiptare por për të gjithë vendin.

Me respekt,

ADMINISTRATORI I SHOQËRISË

Ergys VERDHO